

Prishtinë, 19 Korrik 2007
ERO Code: D_61_2007

Bordi i Zyres së rregullatorit për Energji, duke u bazuar në:

1. Dispozitat e Nenit 15.2 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat e Nenit 38.7 të Ligjit për Energjinë Elektrike;
3. Dispozitat e Nenit 32/9 të Rregullit Për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji;
4. Dispozitat e Nenit 20 të Licencës Operatorit të Sistemit të Transmisionit;
5. Kërkesë zyrtare të Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut të Kosovës (KOSTT) SH.A. të dërguar me date 11 Korrik 2007, **në seancën e mbajtur me date 19 Korrik 2007, nxorri këtë:**

VENDIM

1. Aprovohet Kodi i Standardeve të Energjisë Elektrike;
2. Aprovohet Marrëveshja për Kyçje;
3. Aprovohet Kodi i Sjelljes dhe Etikës së KOSTT SH.A.
4. Ipet pëlqimi në formën e marrëveshjes për blerjen e humbjeve në transmision
5. Ky Vendim do të botohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.
6. Ky Vendim nxirret në tri gjuhë: shqip, serbisht dhe anglisht. Në rast të mospërputhjes midis versioneve të ndryshme, do të mbizotëroj versioni në gjuhën shqipe.
7. Pala e pakënaqur, mund të paraqesë ankesë kundër këtij Vendimi në gjykatën e juridiksionit përkatës, brenda 14 ditësh nga data e miratimit ose datës së publikimit të vendimit në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.
8. Ky Vendim hyn në fuqi datën e lëshimit ose datën e publikimit në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së

Bashkangjitur: Versionet e aprovuara të Kodeve dhe Marrëveshjes.

Bordi i ZRRE:

Ali Hamiti, Kryesues

Theranda Beqiri, Anëtare

Naim Bejtullahu, Anëtar

Nysret Avdiu, Anëtar